



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 81 prot.

Kamëz, më 23.12.2019

V E N D I M

Nr. 56 Datë 23/12 /2019

PËR
PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PER PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM
2021-2023 DHE BUXHETIN VJETOR 2021.

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt 23.12. 2019.

Në mbështetje të nenit 54, të Ligjit nr. nr.139/2015, "Per Veteqeverisjen Vendore" të VKM- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë", Ligji nr. 10 296, dt. 08.07.2010 , "Per Menaxhimin financiar dhe kontrollin", në Ligjin nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"

V E N D O S I

1. Miratimin e kalendarit te përgatitjes se programit buxhetor afatmesem 2021-2023 dhe buxhetit vjetor 2021, bashkelidhur pjese perberese e ketij vendimi.
2. Ky projekt i shtrin efektet nga data 01.01.2020.
- 3..Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

K R Y E T A R

H Y S E N K O L D A S H I





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

**KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM(2021-2023) DHE BUXHETIT
VJETOR**

Nr	Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Afati
1	Parqitja për shqyrtim e miratim te Raportit për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesem te te Ardhurave	Drejtoria e Te Ardhurave	Deri 31 Janar 2021
2	Miratim nga Keshilli Bashkiak i Raportit ; për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesem te te Ardhurave .	Keshilli i Bashkise	Deri 01.03.2021
3	Pergatitja e tavaneve te shpenzimeve te PBA 2021-2023 nivel programi. Diskutimi ne takimin e GMS	Grupi per Menaxhim Stategjik	Deri 01.03.2021
4	Miratimi i tavaneve te shpenzimeve te buxhetit afatmesem PBA 2021-2023	Keshilli i Bashkise	Brenda 15 Marsit 2021
5	Pergatitja dhe miratimi i udhezimit te pergatitjes se PBA dhe buxhetit Vjetor dhe shperndarja ne NJ.Shpenzuese .	Kabineti i Kryetarit Sekretari GMS (Dr,finances)	Brenda Marsit 2021
6	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore	Njesite shpenzuese të bashkisë	21 Mars -25 Prill 2021
7	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2019-2021	Njësia e vetëqeverisjes vendore	26 Prill - 27 Prill 2021
8	Njësitet shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura	Njësitet shpenzuese të Bashkisë	28 Prill - 30 Prill 2021
9	Organizon seancat dëgjimore me Banorët	Kryetari i NJQV-së	16 Maj - 26 Maj 2021

10	Prezanton dokumentin e PBA 2021-2023 me shoqërinë civile	Kryetari i NJQV-së	27 Maj - 29 Maj 2021
11	Hartimi i dokumentit të parë të PBA 2021-2023, Diskutimi në takim të GMS. Dërgimi në MF i Projekt dokumentit të PBA	G.M.S Kryetari i Bashkisë	Brenda dt 01.06.2021
12	Shqyrtimi dhe miratimi nga keshilli Bashkiak i Projektin e parë të PBA , duke su njohur edhe me rekomandimet e Ministrisë së Financave.	Keshilli Bashkiak	Brenda 30 Qershorit 2021
13	Përgatitja e tavanëve përfundimtare të PBA në nivel programi , pas daljes së udhëzimit plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor nga Ministria e Financave.	Drejtoria e Financës	Brenda Qershorit pas daljes së UMF v.2021
14	Miratimi i tavanëve përfundimtare të PBA 2021-2023	Keshilli Bashkiak	Brenda 20 Korrikut 2021
15	Përgatitja e udhëzimit për përgatitjen e Buxhetit të njesive së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarjen tek Njesitë Shpenzuese : a.tavanet përfituese b.afatet e përgatitjes së kërkesës të rishikimit të PBA 2021-2023.	Sekretari GMS Drejtoria e Financës	5 ditë pas miratimeve të tavanëve
16	Përgatitja e projektit të rishikuar të PBA 2021-2023. Organizimi i seancave degjimore me komunitetin (Nj. Administrative , Lagjet e e Qytetit , Grupet e interesit, shoqëria civile) Hartimi i planit të masave dhe veprimet për organizimin e degjësive publike për PBA-ne .	Kabineti i Kryetarit Sekretari i GMS	Korrik – Gusht v.2021
17	Miratimi i PBA të rishikuar në Keshillin Bashkiak Njohja e Keshillit me rekomandimet e dhëna nga MF	Keshilli Bashkiak	Brenda 15 shtator 2021
18	Pas miratimit të PBA të rishikuar përgatitja e Projekt Buxhetit Vjetor , parashikimi për çdo ze të ardhur dhe shpenzimi: Për çdo program. Për çdo Njësi shpenzuese.	Drejtorite e Bashkisë , Ndërmarrjet dhe Institucionet e varesive	Tetor -10 Nëntor v.2021
19		Keshilli Bashkiak	

19	Miratimi nga Keshilli Bashkiak i Buxhetit Vjetor dhe i PBA perfundimtare 2021-2023.	Keshilli Bashkiak	Dt 25.12.2021
20	Dergimi i nje kopjeje te Buxhetit Vjetor dhe i PBA perfundimtare 2021-2023, ne Ministrine e Financave.	Sekretari GMS	5 dite nga data e miratimit
21	Publikimi i Buxhetit Vjetor dhe i PBA perfundimtare se bashku me dokumentacioni shoqerues Ne faqen zyrtare te Bashkise Buletini e Njoftimeve Publike	Drejtoria e Burimeve Njerezore	5 dite pas miratimit nga Keshilli Bashkiak

KRYETAR

HYSEN KOLDASHI

